

ishte larguar nga fshati ditën e mëparshme. Haziri ka mbetur vetëm në shtëpi. Nga ajo ditë, familja nuk e ka takuar atë kurrë më. Është i evidentuar në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së. Lënda e tij e mban numrin rendor BLG-803256-01.

Burimet: deklarata S.Q, FDH-17912; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; FDH, *Fati...*, FDH-8322; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor FDH-31815.

Muzli (Osë) Hulaj

(19.02.1940, shqiptar nga fshati Hulaj/Huljaj, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, katër fëmijë)

Muzliu dhe familja e tij e kanë braktisur Hulajn/Huljaj më 31.05.1998. U strehuan në fshatin fqinj të Pobërgjes/Pobrde. Të nesërmen, më **1.06.1998**, Muzliu ka marr vendim që të kthehej në **Hulaj/Huljaj** për të lëshuar bagëtinë në kullotë. Ishte kjo hera e fundit që familjarët e shihnin të gjallë. Po atë ditë, por më vonë, bashkëshortja e Muzliut, Timja, vuri re se në Hulaj/Huljaj po digjeshin shtëpitë. Pas përfundimit të luftës, familja e Muzliut u rikthye në Hulaj/Huljaj. E kanë gjetur shtëpinë të shkrumbuar, por nuk kishte asnjë gjurmë të Muzliut. Në qershor të vitit 2004, zyrtarët e KNKK-së e kanë njoftuar familjen se mbetjet mortore të Muzliut ishin zbuluar në varrezën masive në Petrovo Sellë në Sërbi. Në datën 27.06.2004, familja i ka marr mbetjet mortore të Muzliut në morgun e Rahovecit/Orahovac. Po atë ditë, ai është varrosur në varrezat e Hulajt/Huljaj.

Burimet: deklarata T.H, FDH-17913; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297; FDH, *Fati...*, 65, FDH-8322.

Xyfe (Ukshin Ganijaj) Cenaj

(1908, shqiptare nga Lloqani/Loçane, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, një fëmijë)

Dinë (Rexhep) Cenaj

(16.10.1939, shqiptar nga Lloqani/Loçane, komuna e Deçanit/Deçani, hidraulik, katërm-bëdhjetë fëmijë)

Pas sulmit të forcave serbe mbi fshatin [**Lloqan/Loçane**] më 29.05.1998, atje ka mbetur kryesisht popullata e moshuar dhe

burrat që vendosën ta mbronin pragon e shtëpisë. Familja e Dinë Cenajt e ka braktisur fshatin në të njëjtën natë, por ai dhe halla e tij e moshuar, Xyfa, kanë mbetur në shtëpi. Dy ditë më vonë, familjarët kanë dëgjuar nga disa njerëz, që kanë mbetur për të mbrojtur fshatin, se forcat serbe e kanë sulmuar sërish Lloqanin/Loçane më **1.06.1998** dhe se Dinë Cenaj kishte tentuar që ta nxirrte nga shtëpia hallën Xyfen. Nga ajo ditë, atyre u është humber çdo gjurmë. Janë evidentuar nga KNKK-ja si të zhdukur dhe rastet e tyre janë sistemuar në lëndët me numrat rendor BLG-802095-01 [Dinë Cenaj] dhe BLG-803271-01 [Xyfe Cenaj].

Burimet: deklarata A.C, FDH-18700; deklarata Z.C, FDH-18945; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; ICTY, IT-04-84 (Haradinaj dhe të tjerë), Ex.D34, FDH-29363.

Zize (Tahir Bozhdaraj) Tolaj

(25.06.1926, shqiptare nga Pobërgja/Pobrde, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, tre fëmijë)

Shkurte (Ibish Vishaj) Tolaj

(1929, shqiptare nga Pobërgja/Pobrde, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, katër fëmijë)

Herët në mëngjes të datës **1.06.1998**, nga ora 8:00, forcat serbe kanë depërtuar në fshatin **Pobërgjë/Pobrde**. Të gjithë ata banorë, të cilët nuk e braktisën fshatin një ditë më herët, nisën të largoheshin me nxitim nga shtëpitë e tyre. Kushërirat e moshëthyer, Zize, Shkurte dhe Dyke Tolaj nuk e braktisën fshatin. U strehuan në shtëpinë e së afërmes së tyre, Zize, që ishte e martuar me Salih Tolajn. Por, gjatë sulmit mbi fshatin, forcat serbe e kanë hedhur një bombë mbi shtëpinë ku gjendeshin ato, e më pas me një tank e rrënuan derën e oborrit. Të gjithë dolën jashtë dhe nisën të vraponin drejt shtëpisë së Hasan dhe Zize (Tahir) Tolajt. Bashkëshortja e Salihut, Zize, dhe Dykja ia arritën që të futeshin në brendi të shtëpisë, por bashkëshortja e Hasanit, Zize, dhe Shkurte Tolaj nuk ia dolën, sepse forcat serbe kanë shtënë drejt tyre, duke i qëlluar që të dyja për vdekje. Më pas i kanë vënë zjarrin shtëpisë, por Dykja dhe Zizja, bashkëshortja e Salihut, arritën që të largoheshin pa u vërejtur. Pas përfundimit